

Kontakt : zyraekarrieres@upt.al

Zyra e Këshillimit të Karrierës përfaqëson një nga sektorët e Drejtorisë së Komunikimit, pranë Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës. Misioni i saj është të orientojë, inkurajojë dhe mbështesë studentët dhe të diplomuarit me mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit në karrierë.

Zyra e Këshillimit të Karrierës ofron një gamë të gjerë shërbimesh për studentët dhe të diplomuarit e UPT të cilat kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Shërbimet kryesore që Zyra e Këshillimit të Karrierës ofron janë:

- Identifikimi dhe informimi mbi oportunitetet edukative (internshipe, bursa, trajnime, etj.);
- Asistencë për realizimin e instrumenteve të kërkimit të një vendi pune (përgatitja e CV, letër motivimi, etj.);
- Këshillim karriere nëpërmjet vlerësimit të interesave, vlerave dhe aftësive profesionale;
- Trajnime/work shope për zhvillimin e qëndrimeve dhe aftësive që mund të rrisin mundësitë e futjes së të diplomuarve në tregun e punës;
- Informimi dhe promovimi i ofertave të internshipeve, vendeve të punës, etj.;
- Këshillimi i studentëve të UPT që diplomohen në Ciklin e Parë për mundësitë e studimeve në Ciklin e Dytë në UPT ose universitete të tjera jashtë vendit;
- Organizimi i selektimit dhe rekrutimit të studentëve;
- Mbajtja e kontaktit me alumnët dhe ndërthurja e kërkesave dhe ofertave të edukimit gjatë gjithë jetës;
- Lidhja e vazhdueshme dhe aktive me kompanitë brenda dhe jashtë vendit si dhe vlerësimi/ analiza e kërkesave të tyre për forcë pune;
- Aktivitete të ndryshme promovuese dhe informuese;
- Informimi i studentëve të ardhshëm (maturantë) për programet e studimit, standardet e pranimit dhe politikat e UPT;
- Mbajtja e kontaktit dhe të dhënave për punësimin e të diplomuarve të UPT;